



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA  
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS		VRHOVNI SUD KOSOVA
GJ.A-Su.A	<u>771/13</u>	
Dt:	<u>18.12.2013</u>	
PRISHTINË - PRIŠTINA		

Date: 12.12.2013

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe Gjyqtarëve të EULEX-it , në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 12.12.2013, jep këtë

MENDIM JURIDIK

Për ankesën e paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është hedhur, si i pasafatshëm, kundërshtimi i të pandehurit i paraqitur kundër propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, parashikuar nga neni 496. par. 4 të KPPK, duhet të vendosë kolegji shqyrtues i së njëjtës gjykatë.

A r s y e t i m i

Gjykata e Apelit në Prishtinë ka parashtruar një kërkesë, me të cilën kërkon nga kjo Gjykatë që të marrë qëndrim parimor, lidhur me nenin 496 par. 5 të KPPK, lidhur me atë se kush duhet të vendosë me rastin e ankesës së paraqitur kundër aktvendimit me të

cilin është hedhur si i pasafatshëm kundërshtimi i të pandehurit, i paraqitur kundër aktgjykimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor, parashikuar nga neni 496. par. 4 të KPPK.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme, mendon se me rastin e ankesës së paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është hedhur si i pasafatshëm kundërshtimi i të pandehurit, i paraqitur kundër aktgjykimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor, parashikuar nga neni 496. par. 4 të KPPK, duhet të vendosë Paneli shqyrtues i së njëjtës gjykatë për arsye si në vijim:

Në nenin 494 par. 1 të KPP është përcaktuar se “Kur një gjyqtar i vetëm e hedh poshtë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor për vepra penale për të cilat nuk mund të paraqitet një kërkesë e tillë ose kur prokurori i shtetit kërkon shqiptimin e dënimit i cili sipas ligjit nuk është i lejueshëm, kolegji shqyrtues, në afat prej 48 orësh, vendos për ankesën e prokurorit të shtetit kundër vendimit për hedhjen e kërkesës”, ndërsa në rastin e parashikuar nga neni 496 par. 5 të KPP, thuhet se “vendos kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë”, pa e saktësuar se është fjala për kolegji shqyrtues, apo për një kolegji të Gjykatës së Apelit

Bazuar në përkufizimin ligjor të shprehjeve nga neni 19 par. 1 pika 1.23 të KPP, shprehja “kolegji shqyrtues” është përkufizuar si kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës themelore, të cilët kanë kompetencë të vendosin lidhur me kundërshtimet e paraqitura kundër urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake, ndërsa në rastin e paraqitjes së ankesës kundër aktvendimit për hedhjen poshtë të kundërshtimit të paraqitur kundër urdhrin ndëshkimor, nuk bëhet fjalë për vendosje lidhur me kundërshtimin ndaj urdhrin ndëshkimor të gjyqtarit të procedurës paraprake, por fjala është për vendosje lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të gjyqtarit të vetëm, i cili, në këtë rast, nuk e ka cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake, por cilësinë e gjyqtarit gjykues.

Në Kodin e Procedurës Penale, për situata të njëjta nuk janë përdorë shprehje konsistente, diku është përdorë shprehja kolegji shqyrtues, diku paneli prej tre gjyqtarësh (edhe paneli shqyrtues përbëhet prej tre gjyqtarëve) pastaj edhe pse sipas nenit 19 par. 1 pika 1.23 të KPP është përcaktuar së kolegji shqyrtues është kolegji i përbërë prej tre gjyqtarësh, i cili formohet nga Departamenti i njëjtë ose nga Gjykata themelore për të

shqyrtuar dhe për të gjykuar një kundërshtim kundër urdhrimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, ky kolegji në situata të caktuara vendosë jo vetëm për kundërshtimet ndaj urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake, por edhe për ankesat e palëve, psh. kur gjyqtari i procedurës paraprake ia ndërprejë paraburgimin të pandehurit (neni 192) etj.

Nga elaburimet që u dhanë, rezulton se me rastin e ankesës së paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është hedhur si i pasafatshëm kundërshtimi i të pandehurit i paraqitur kundër propozimit për dhënien e urdhrimit ndëshkimor, parashikuar nga neni 496 par. 4 të KPPK, duhet të vendosë kolegji shqyrtues i së njëjtës gjykatë, me gjithë faktin se norma nuk ka përdorur shprehjen kolegji shqyrtues, por ka përdorur shprehjen kolegji prej tre gjyqtarëve gjë që nënkuptohet vetvetiu, për arsye se edhe sipas nenit 19.1.21 të KPPK, kolegji shqyrtues është kolegji i përbërë prej tre gjyqtarësh, kështu që, nëse për hedhjen e kërkesës për dhënien e urdhrimit ndëshkimor vendos kolegji shqyrtues (neni 494 par. 1), edhe pse vendimi nuk është i gjyqtarit të procedurës paraprake, pse atëherë në rastin e kundërshtimit të të pandehurit të mos vendosë i njëjti kolegji shqyrtues (kur e kemi situatën e njëjtë).

Dr.sc. Fejzullah Hasani

Kryetar i Gjykatës Supreme të republikës së Kosovës

